

Institucionalizimi dhe emancipimi

përpiluar nga redaktorët

Përpykja për drejtësi | Drejt një përfaqësimi ndërkombëtar | Zgjidhja e "lëvizjes romani" – kongresi i parë botëror romani (1971) | Kongresi i dytë botëror romani (1978) | Njohja e gjenocidit dhe institucionalizimit të politikave romë | Një zhvendosje në lindje | Pjesëmarrja politike në nivel nacional dhe të komunitetit | Sfida e bashkëpunimit | Perspektivat e ardhshme

➤ Për pjesën më të madhe të shekullit të 20-të, aktivitetet emancipuese në masë të madhe mbetën eksperimente të izoluar. Në vitet e 1950-ta dhe 60-ta, një numër në rritje i organizatave u krijua, duke përgatitur rrugën për "Lëvizjen Romani" të viteve të 1970-ta. Në këtë dekadë u shfaqën organizatat lokale dhe nacionale romë në numër të madh dhe më qëllime të ndryshme, dhe u bënë përpjekje domethënëse drejt përfaqësimit politik të romëve në nivel ndërkombëtar. Që nga viti 1989, në disa vende të Evropës lindore romët gjithnjë e më shumë janë përfaqësuar në organet politike komunale dhe nacionale.

« GELEM, GELEM »

"Gelem, Gelem" u propozua për himn zyrtar të romëve në Kongresin e parë botëror Romani në Londër, 1971. Është shumë e mundur që ky himn është kënga më së shpeshti e incizuar romë sot.

III.1

(teksti Romani ishte shkruar nga Zharko Jovanović gjatë Kongresit të vitit 1971, pas një melodie tradicionale.)

GELEM, GELEM

*Gelem, gelem, lungone dromensa
Maladilem baxtale Romensa
A Romale katar tumen aven,
E carensa baxtale dromensa?
A Romale, a Čhavale
Vi man sas ek bari familija,
Murdadas la e kali legija
Aven mansa sa lumnijake Roma,
Kaj putajile e romane droma
Ake vrijama, ušti Rom akana,
Men khutasa mišto kaj kerala!
A Romale, a Čhavale*

UDHËTOVA, UDHËTOVA

*Udhëtova, udhëtova rrugë të gjata,
Dhe takova romë të lumtur
O Romë, prej nga erdhët,
Me tenda në rrugët e lumtura?
O Romë, o shokë Romë
Një herë pata një familje të madhe
Legjioni i Zi i vrau
Tani ejani, të gjithë Romët e botës
Sepse rrugët Romani janë hapur
Tani është koha, tani ngrihuni Romë,
Do të ngrihemi lart nëse veprojmë!
O Romë, o shokë Romë*

PARATHËNIE

Përpykjet e para për aktivitetet emancipuese të romëve buruan në vendet e Evropës lindore.

Në fund të shekullit të 19-të, Lazar Naftanaila ishte i pari që provoi të organizonte romët e Rumanisë në "Infra-tirea Neorustica" (Shoqata e Vëllazërisë së Fermerëve të Rinj). Në Bullgari, janë të regjistruara mbledhjet për vitin 1905 dhe 1906, ku udhëheqësit romë përpiluan peticione në parlamentin nacional, duke kërkuar të drejta elektorale për po-

pullin e tyre, që iu kishte marrë nga ta. Duke filluar në Poloni dhe Rumania në vitet e 1930-ta, përpjekjet e para u bënë për bashkimin e organeve përfaqësuese të një vendi dhe themelimin e organizatave nacionale. Mirëpo, përpjekjet e tilla, më shpesh se jo, dështonin për shkak të rivaliteteve të brendshme dhe pretendimeve për udhëheqësi.

Në Rusinë Sovjetike, me ndihmën e shtetit, në vitin 1925 një shoqëri vullnetare u bë "Unioni Gjithë-Rus i Ciganëve",

i udhëhequr nga Andrei Taranov, anëtar i Partisë Komuniste Gjithë-Bashkuese (Bolsheviks), dhe Ivan Rom-Lebedev. Shpërbërja e unionit në vitin 1928 nuk ndikoi në shumëllojshmërinë e aktiviteteve kulturore, sociale, dhe edukative të cilat u shfaqën atëherë dhe vazhduan deri në ndryshimin e përgjithshëm të politikave shtetërore në fund të viteve të 1930-ta.

Në vendet e Evropës perëndimore, fare nuk kishte aktivitete të ngjashme para Luftës së Dytë Botërore.

Përpjekja për drejtësi

Drejt një përfaqësimi ndërkombëtar

Zgjidhja e "lëvizjes romani" – kongresi i parë botëror romani (1971)

Kongresi i dytë botëror romani (1978)

AKTIVITETET EMANCIPUESE TË ROMËVE NË VENDET KOMUNISTE

Edhe pse romët e Evropës lindore, posaçërisht të Jugosllavisë, do të luanin rolin kyç në aktivitetet emancipuese në një nivel ndërkombëtar, ato kryesisht buruan në Evropën perëndimore. Kjo është kryesisht për shkak të faktit se vetë themelimi dhe zhvillimi i organizatave romë në vendet komuniste nuk ishte i mundshëm pa aprovimin dhe përkrahjen aktive të shtetit dhe strukturave partiake.

"Organizata e Bashkuar e Përgjithshme Kulturore e Minoriteteve Cigane 'Ekhipe'" ("Ekhipe": në gjuhën Romani "unitet") në Bullgari e udhëhequr nga Shakir Pashov, një aktivist shumë i njohur romë dhe funksionar i Partisë Komuniste Bullgare, u krijua me 6 mars, 1945. "Ekhipe" vendosi shumë degë lokale dhe gazeta "Romano Esi" ("Zëri i Romëve") u publikua (më vonë e riemëruar "Nevo Drom" – Rrugë e Re

– së bashku me "Teatri Qendror Cigan Muzikor i Romëve"). Kah fundi i viteve të 1940-ta politika ndryshoi rrënjësisht, dhe Shakir Pashov u dëbua nga Partia Komuniste Bullgare dhe u dërgua në kampin e përqendrimit në Belene, shtypi romë dhe teatri pushuan së ekzistuari dhe degët lokale të organizatave romë u bënë pjesë e "Fronti i Vatani" (një organizatë masive publike e dominuar nga Partia Komuniste Bullgare). Në vitin 1957 një përpjekje u bë për ringjalljen e lëvizjes së organizuar të romëve; mirëpo, kjo shpejt u ndërpre dhe romët tërësisht u vendosën në kuadër të Frontit të Vatani i cili gjithashtu publikoi gazetë "Jeta e re Cigane" (deri në vitin 1988). [III. 3]

Në Hungari, "Magyar Ciganyok Mívelődési Szövetség" (Shoqata Kulturore Hungareze e Ciganëve) e udhëhequr nga Maria Laszlo u krijua në vitin 1957. Ajo u përpoq të zgjeroj aktivitetin e saj dhe ta kthej në një organizatë minoritare nacionale, por ajo ekzistoi vetëm dy vjet. "Ciganszövetség" (Këshilli Cigan) i udhëhequr nga Menyhert Lakatos u krijua

PËRPJEKJA PËR DREJTËSI

Pas vitit 1945, kur shumica e qeverive nuk morën përgjegjësinë për krimet e kryera gjatë kohës naziste dhe nuk ndjenin nevojën për tu përballur me pasojat, romët nuk kishin një lobim mjaft të fortë. Vetëm organizatat e veçanta jo-rome u ngritën për minoritetin edhe një herë të kufizuar. Mirëpo, puna e tyre për drejtësi dhe barazi nuk solli arritje domethënëse.

Mohimi i të drejtave themelore, siç është rasti me Gjermaninë, ku romët (që do të thotë kryesisht Sinti) u injoruan në procesin e riparimit, si dhe diskriminimi i vazhdueshëm rezultuan në themelimin e organizatave të reja.

Duke filluar nga vitet e 1950-ta, shoqatat të ndryshme Sinti u krijuan në Gjermani, qëllimi i kryesor i të cilave ishte të ndihmonin që të mbijetuarit e persekutimit nazist të kërkonin të drejtën e tyre për kompensim dhe ti përkrahnin gjykimet kundër ish torturuesve. Më vonë, ata zgjeruan aktivitetin e tyre në luftimin për të drejta civile dhe barazi sociale për Sinti.

Një moment i rëndësishëm në historinë e emancipimit të romëve ishte themelimi i "Verband rassisch verfolgter nicht-Juden" (Shoqata e jo-Çifutëve të persekutuar në baza racore) nga Oskar dhe Vinzenz Rose në vitin 1956. Nga kjo

shoqatë u zhvillua "Verband Deutscher Sinti" (Shoqata e Sinti-ve gjerman) në vitin 1972, organizatat lokale dhe regjionale të së cilës përfundimisht u bashkuan për të formuar "Zentralrat Deutscher Sinti und Roma" (Këshilli Qendror i Sinti dhe Romëve gjerman) në vitin 1982. Edhe pse të sfiduar në kërkesën e saj për përfaqësimin e të gjithë Sinti dhe Romëve që jetonin në Gjermani, kjo organizatë në mënyrë efektive i trajtoi çështjet e riparimit dhe njohjes zyrtare të Sinti dhe Romëve dhe u bë një nga organet më me ndikim për përfaqësimin e romëve në Evropë.

Veç në vitin 1968, çështja e pazgjidhur e nacionalitetit dhe statusi i paqartë i banimit për romët imigrues kishte rezultuar në themelimin e Komisionit Ndërkombëtar për të Drejtat e Ciganëve në Hamburg. Sidoqoftë, në vitin 1969 krijimi i parashikuar i një përfaqësimi të bashkuar gjerman dështoi për shkak të kërkesave konfliktuozë të udhëheqjes nga delegatët romë si dhe dallimeve në opinion lidhur me kompetencat e komitetit trans-regjional dhe trans-grupit romë.

DREJT NJË PËRFAQËSIMI NDËRKOMBËTAR

Sikurse ishte rasti në Gjermani, u bënë përpjekje në Francë për bashkimin e të gjitha grupeve romë që jetonin në vend

në kuadër të një përfaqësimi të përbashkët. Franca për më tepër funksiononte si një pikë fillestare për përpjekjet drejt shlyerjes së procesit të filluar të vetë-organizimit në një nivel ndërkombëtar.

Në vitin 1960, Ionel Rotaru themeloi "Communauté Mondiale Gitane" (Komunitetin Botëror Cigan, CMG) në Paris. Nga CMG, që u shpërbë nga qeveria franceze në vitin 1965, "Comité International Tzigane" (CIT) u zhvillua. E udhëhequr nga Vanko Rouda, komiteti si hap të parë kishte për qëllim tejkalinimin e kufijve ekzistues në mesin e romëve që rezultonin nga dallimet nacionale, religjioze, dhe grupore. CIT, e cila punonte së bashku me Kishën Ungjillore Romani e themeluar në vitin 1952 nga Clement Le Cossec, vëri kontakt me organizatat e huaja si "Këshilli Cigan" në Britani të Madhe (i krijuar me 1966) dhe "Këshilli Nordik i Romëve" në Suedi (i krijuar më 1973).

Qëllimi i deklaruar i CIT-së ishte ndërprerja e asimilimit të detyruar dhe përmirësimi i kushteve ligjore dhe sociale të romëve në tërë botën. Për këtë qëllim, CIT përdori strategji moderne: marrëdhëniet publike, fushatat mediale, demonstratat dhe lobimet që kishin për qëllim ti shtynte qeveritë dhe shoqërinë të ndërronin mënyrën e tyre të mendimit dhe t'i ndihmonin romëve në arritjen e një niveli më të lartë të barazisë. CIT, e riemëruar "Komiteti Lumniako Roma-

në vitin 1974, dhe në vitin 1985 u pasua nga “Orszagos Cigan-nytanacs” (Këshilli Nacional Cigan) të udhëhequr nga Jozsef Daroczi. Organizata e re rome kryesisht ishte një faktor aktiv në sferën kulturore.

Në Çekosllovakia organizatat rome ekzistuan vetëm për një kohë të shkurtë. “Zváz Ciganov-Romov” (Unioni i romëve Cigan) i udhëhequr nga Anton Facuna u krijua në vitin 1968 në Sllovakia, dhe në vitin vijues ngjashëm u krijua “Svaz Cikanu-Romu” (Unioni i romëve Cigan) në Republikën Socialiste Çeke. Dy organizatat u shndërruan në një nën “Fronti i Popullit” (një organizatë masive publike e dominuar nga Partia Komuniste). Organizatat rome krijuan një rrjetë të degëve lokale dhe tentuan të kryejnë aktivitete në sferën e punësimit, në përmirësimin e kushteve të banimit dhe edukimin e fëmijëve romë, në zgjidhjen e problemeve të grave rome dhe në fushën e promovimit të kulturës rome. Mirëpo, ato ekzistuan vetëm për disa vite dhe u shpërbën në fillim të viteve të 1970-ta.

Situata në Jugosllavi është një rast specifik. “Shoqata rome”, e krijuar në vitin 1969, krijoj degët dhe shoqatat tjera rome në tërë vendin. Në vitet e 1970-ta, ekzistonin më shumë se 60 organizata rome, ndërsa numri i tyre vazhdimisht rritej. Në vitin 1986 ato u bashkuan në një Union të Shoqatave Rome në Jugosllavi.

Në fakt, në vendet tjera të Evropës lindore nuk ekzistonte ndonjë lëvizje e organizuar rome. Në Poloni dhe Rumani disa shoqata lokale rome, aktivitetet e të cilave ishin të kufizuara në sferën e kulturës, u krijuan në vitet e 70-ta (organizimi i shkollave dhe grupeve për muzikën dhe vallëzimin romë, pjesëmarrja në ahengje dhe festivale, etj). Aktivitetet e ngjashme u organizuan në shkallë të gjerë në dhjetëra ansamble muzikore dhe vallëzuese rome në Bashkimin Sovjetik, dhe kishte shembuj sporadik madje edhe në Shqipëri.

III. 2

(nga Elena Marushiakova / Veselin Popov)

no” (në frëngjisht “Comité International Rom”, CIR) në vitin 1971, gjithashtu lëshoi një botim periodik, “La Voix Mondiale Tsigane”. Në vitin 1971, CIR formalisht organizoi Kongresin e parë botëror Romani. Deri në vitin 1972, njëzet e tri organizata ndërkombëtare në njëzet e një vende, përfshirë Kanadën dhe Australinë, ishin lidhur përmes CIR.

ZGJIMI I “LËVIZJES ROMANI” – KONGRESI I PARË BOTËROR ROMANI (1971)

Lansimi i të ashtuquajturës “Lëvizje Romani” shkaktoi një ndryshim rrënjësor në sjelljen e shoqërive rome në trajtimin e realiteteve politike dhe sociale: për kohën më të gjatë, fati i romëve ishte definuar prej “jashtë” nga popullsitë shumicë. Modelet e tyre të sjelljes përgjatë shekujve korrespondojnë me të ashtuquajturën “shoqëri dalëse”, ashtu siç karakterizohej nga shmangja e konflikteve dhe ikja nga kushtet e pafavorshme.

Kah fillimi i viteve të 1970-ta, një elitë e vogël por e duhur rome ishte formuar në Evropën lindore dhe perëndimore, e cila për herë të parë ngriti zërin për çështjet rome në publik dhe tregoi kundërshtim ndaj statusit të parashkruar social dhe ekonomik të romëve. [III. 2]

Përpjekja për barazi dhe njohje sociale në masë të madhe ishte pasojë e

ndryshimit të mënyrës së si romët merreshin me identitetin e tyre. Asimilimi në popullsinë shumicë dhe vetë mohimi u zëvendësuan me përkrahjen e qartë publike dhe pranimin e kulturës rome. Integrimi nuk do të varej më në humbjen e identitetit kulturor. Romët kërkuan të njiheshin dhe respektoheshin nga shoqëria si romë. Bashkë me kërkesat politike, ishte një përpjekje për përshkrimin e historisë dhe kulturës së romëve nga brenda dhe kjo të arrihej në duart e jo-romëve.

Formimi i Kongresit botëror Romani në vitin 1971 përbën një arritje të madhe në lëvizjen e re politike. Konferenca e saj e parë në Londër me pjesëmarrës nga 14 shtete ishte një shprehje e nevojës për “unitet ndërkombëtar”, luftim kundër kufizimit shoqëror dhe një përpjekje e përbashkët për një ardhmëri pozitive.

Bazuar në ekzistencën e të ashtuquajturit “Kombi Romani”, kënga “Gelem, Gelem” ishte propozuar si himn zyrtar Romani dhe një flamur i përbashkët u krijua. Motoja “Opre Roma!” u bë besimi politik i Lëvizjes Romani dhe luftimi i saj për drejtësi dhe barazi sociale. Zgjedhja e shprehjeve “Rom” dhe “Romani” si emërtime zyrtare do të rrënonte paragjykimet e vjetra dhe do të ndihmonte në krijimin e vetëbesimit të ri. Slobodan Berberski u zgjodh President Nderi, Dr. Jan Čibula nga Çekosllovakia (Nën-)President, dhe Grattan Puxon, Udhëheqës i

Këshillit Britanik Cigan, Sekretar Gjeneral, dhe u krijuan komisionet të cilat merreshin me krimet e luftës, kushtet sociale dhe ekonomike, si dhe gjuhën dhe kulturën e romëve. [Illa. 1, 4, 5]

KONGRESI I DYTË BOTËROR ROMANI (1978)

Kongresi i Londrës nxiti dhe përforcoi aktivitetet emancipuese në gjithë botën, që shkaktuan formimin e organizatave tjera politikisht aktive të romëve brenda dhe jashtë Evropës. Rrjedhimisht, Kongresi i dytë botëror Romani, që u mbajt në Gjenevë në prill të vitit 1978, tanimë kishte pjesëmarrjen e jo më pak se 50 organizatave rome nga e tërë Evropa, Shtetet e Bashkuara, India dhe Pakistani. Një hap i rëndësishëm për të ardhmen ishte formimi i Unionit Ndërkombëtar Romani (IRU) në vitin 1977, duke iu bashkëngjitur përfaqësuesve regjional dhe nacional. Në vitet dhe dekadat vijuese, IRU arriti të tërhiqte vëmendjen më të madhe të qeverive për çështjet rome dhe ti shtynte romët të lobonin me dhe brenda komunitetit ndërkombëtar. Në vitin 1979 IRU u pranua në këshillat ekonomike dhe sociale të OKB-së si një organizatë private.

Njohja ndërkombëtare e lëvizjes Romani arriti impulse të reja, me ndihmën e Indisë. Politikanët indian punuan në krijimin dhe intensifikimin e kontakte-



III. 3
Shakir Pashov (qendër) në mesin e pjesëmarrësve në konferencën e Organizatës Gjithë-Cigane kundër Fashizmit dhe Racizmit dhe për Promovimin e Zhvillimit Kulturor të Minoritetit Cigane në Bullgari, 12-13 mars, 1949. (nga arkivat e Studii Romani, Sofia, Bullgari)



III. 4
Pjesëmarrësit në Kongresin e parë botëror Romani, të mbajtur në Londër 1971, duke kënduar himnin "Gelem, gelem" (me fjalët nga Jarko Jovanović, palltoja e bardhë). Jan Čibula (në fund majtas) më vonë u bë kryetari i parë i Unionit Ndërkombëtar të Romëve dhe Grattan Puxon (në fund djathtë) luajti një rol kyç në organizimin e kongresit të dytë. Walsall, 1971. Prapa (l dhe r) janë Ladislav Demeter, Vanko Rouda dhe Juan de Dios Ramirez. (nga Acton / Klimová 2001, f. 159)

ve kulturore në mes të romëve dhe vendit të tyre të origjinës. Gjatë një festivali ndërkombëtar të romëve që u mbajt në Chandigarh, Kryeministri Indian, Indira Ghandi pranoi një delegacion romë, duke iu garantuar romëve përkrahjen e Indisë në prezencën e Kombeve të Bashkuara.

NJOHJA E GJENOCIDIT DHE INSTITUCIONALIZIMIT TË POLITIKAVE ROME

Kongresi i tretë botëror Romani u mbajt në Göttingen në vitin 1981. Marrë parasysh shkeljet të vazhdueshme të të drejtave civile, 300 delegatë nga 22 vende kërkuan që Dosja Helsinki të aplikohet për popullin romë. Një theks tjetër i diskutimit që bëhej nën patronazhin e "Gesellschaft für bedrohte Völker" (Shoqërisë për Përkrahjen e Popujve të Rrezikuar) ishte fati i romëve gjatë kohës së Nacional Socializmit. Qeveria gjermane ishte kërkuar ta njihje gjenocidin ndaj romëve dhe të gjente një zgjidhje të përshtatshme për problemin e riparimit. Gjatë gostisë së përfaqësuesve të Këshillit Qendror të Sinti dhe Romëve gjerman me Kancelarin Schmidt (më vonë

edhe me udhëheqësin opozitar Kohl), kjo njohje zyrtare e gjenocidit u arrit në vitin 1982. Për më tepër, u krijuan fondet për riparimin dhe financimin e organizatave të Sinti dhe Romëve.

Ky sukses kishte ndikime pozitive në vetë-besimin e tërë lëvizjes. Përveç kësaj, në periudhën kohore në mes të kongresit të tretë dhe të katërt (të mbajtura në Varshavë në vitin 1990) u arrit një përmirësim i kushteve sociale të romëve dhe ruajtje e të drejtave të tyre nacionale dhe minoritare në disa vende. Në mbledhjet me përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme të OKB-së, UNESCO-s, Këshillit Evropian, dhe Komitetit Evropian, çështjet e romëve u diskutuan nga komitetet ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, kushtet e nevojshme për punën e suksesshme të organizatave rome do të mund të krijoheshin. Në vitin 1986, Unioni Ndërkombëtar Romani u bë anëtar i UNICEF-it.

Të ashtuquajturat "Kongresii Autoriteteve Lokale dhe Regjionale të Evropës" si pjesë e Këshillit të Evropës, dhe Komitetit për të Drejta të Njeriut i Parlamentit Evropian vazhdimisht trajtuan situatën e romëve. Pasi që IRU u pranua në OSBE në vitin 1990, Zyra e Përhershme e Kontaktit

për Sinti dhe Romë u krijua në Varshavë si pjesë e Konferencës në vitin 1994.

Në prag të Kongresit të pestë botëror Romani të mbajtur në Pragë në vitin 2000, duhet të kryheshin reformat brenda IRU dhe strukturat e reja duhet të krijoheshin. Ajo çka pasoi ishte themelimi i Parlamentit romë, i cili që nga atëherë e më tej do të përcaktonte drejtimin e politikave të brendshme dhe ndërkombëtare të IRU. Së bashku me parlamentin, që është agjencia vendimtare e unionit, u themelua një organ ekzekutiv në formë të komitetit. Ish Presidenti i IRU-së, Dr. Emil Ščuka u zgjodh President i këtij komiteti që përbëhej nga 15 anëtarë. Kongresi i gjashtë botëror Romani dhe deri më tani i fundit u mbajt në Lanciano, Itali, në vitin 2004, ku u zgjodh Presidenti i ri, Stanislaw Stankiewicz. [Ills. 6, 7]

Sidoqoftë, vetë fakti që problemet e tyre janë duke u institucionalizuar shpesh nuk përmbushin marrëveshjen e romëve. Deri më tani, suksesin e realizimit e kërkesave të romëve nuk është dobësuar vetëm nga rezistenca e qeverive të ndryshme, por vetë romët kanë dallime të mëdha në opinion dhe pikëpamje. Ende ka diskutime të brendshme serioze lidhur me statusin e

ROLI UDHËHEQËS I ROMËVE JUGOSLLAV NË SKENËN NDËRKOMBËTARE

Lëvizja e gjallë e romëve jugosllav shpejt u shfaq në skenën ndërkombëtare. Delegacioni i Jugosllavisë mori pjesë aktive në Kongresin e Parë Botëror të Romëve të mbajtur në vitin 1971. Përfaqësuesit nga 8 vende – dhe pjesëmarrësit nga disa të tjera – morën pjesë, në mesin e tyre ishin 2 nga Evropa lindore (Jugosllavia dhe Çekosllovakia). Slobodan Berberski u zgjodh President Nderi i Kongresit dhe Unionit Ndërkombëtar të Romëve (atëherë i njohur me emrin RIC) u krijua, me Berberskin si president i parë i kësaj organizate ndërkombëtare rome. Sipas dokumentacionit të kongresit një nga detyrat kryesore të organizatës rishitas të themeluar ishte të shpërndante shembullin e Jugosllavisë si shtet me një rol shembullor në qëndrimin e saj ndaj romëve. Madje edhe flamuri i romëve i miratuar në Kongres ekzistonte në dy variante – njëri si “zyrtar”, i njohur për publikun si flamur i kaltër-gjelbër me “chakra” e vjetër indiane në mes, dhe tjetri, për Evropën lindore gjithashtu përfshinte një yll të kuq.

Përkrahja zyrtare jugosllave për Lëvizjen ndërkombëtare të romëve ishte e vazhdueshme dhe mori formë të ndryshme. Në vitin 1974 Festivali i Parë Botëror i Kulturës

Cigane u organizua në Chandigarh, India dhe një delegacion i romëve në festival (kryesisht përfaqësues nga Jugosllavia) u pranua nga Kryeministri Indira Ghandi. Takimi u aranzhua përmes kanaleve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë përmes Lëvizjes së Pa Inkuadruarve (në atë kohë Jugosllavia dhe India ishin anëtarë udhëheqës të lëvizjes së të pa inkuadruarve).

Gjatë fazave të para të zhvillimit të Lëvizjes ndërkombëtare të romëve politika jugosllave ishte një faktor i rëndësishëm në përkrahjen e saj. Delegacioni jugosllav në tri kongreset e para u përkrahën nga shteti dhe ishte më i madhi, që ishte arsyeja pse kishte gjithmonë romë jugosllav në organet udhëheqëse të IRU-së. Në kongresin e dytë në vitin 1978 në Gjenevë, IRU votoi një udhëheqësi të re – Dr Jan Čibula (një emigrant nga Çekosllovakia) u zgjodh President dhe Shaip Yusuf (Jugosllavi) Sekretar i Përgjithshëm. Në kongresin e tretë të IRU-së në vitin 1981 Sait Balic u zgjodh President (në atë kohë anëtar i Komitetit Qendror të Unionit të Komunistëve Jugosllav), dhe Rajko Djuric (Jugosllavi) Sekretar i Përgjithshëm. Fundi i ndikimit jugosllav në Lëvizjen ndërkombëtare të romëve ishte kongresi i katërt i IRU-së në Varshavë në vitin 1990, kur Rajko Djuric u zgjodh President.

III. 5 (ofruan nga Elena Marushiakova / Veselin Popov)

tyre minoritar. Derisa disa organizata përkrahin njohjen e romëve si një komb “joterritorial” ose minoritet “trans-nacional”, të tjerët pretendojnë njohjen e romëve si minoritet nacional ose etnik. Duke marrë parasysh progresin e ardhshëm, duhet të gjendet një status që kombinon anëtarësinë nacionale dhe trans-nacionale.

NJË ZHVENDOSJE NË LINDJE

Në Evropën perëndimore, një numër i organizatave të pavarura u shfaqën prej vitit 1970 e më tej, të financuara nga anëtarët pagues dhe nganjëherë të subvencionuara nga autoritetet nacionale. Pasuria e këtyre shoqatave ishte, dhe ende është, fokusuar në të drejtat e njeriut, dhe në çështjet kulturore ose arsimore. Në Francë dhe Britani të Madhe, interesi kryesisht përqendrohej në problemet me të cilat përballej populli romë, si armiqësia nga popullsia shumicë, mungesa e vendeve të duhura të karvanit, dhe problemet edukative. Deri në ditën e sotshme, shumë arritje janë bërë nga organizatat në Britani të Mad-

he, Francë, Gjermani, Skandinavi dhe në vende tjera. Për shembull, romët autokton u shpallën minoritet nacional me të drejta të posaçme në Austri (1993), në Finlandë (1995), dhe në Gjermani. Kryesisht për shkak të numrit relativisht të vogël të romëve në shumicën e vendeve perëndimore, promovimi i përfaqësimit politik nuk ishte prioritet i aktivistëve.

Me iniciativat e “Unionit Roma & Cinti” me bazë në Hamburg (i krijuar me 1980), u krijuan EUROM dhe, pas një kohe të shkurtë, Kongresi nacional i romëve (RNC). RNC-ja, përveç IRU-së organizata e dytë më e madhe ndërkombëtare e romëve, ka fokusuar aktivitetet e saj në njohjen e romëve si minoritetet evropian dhe miratimin e “Kartës Rome” nga organizatat ndërkombëtare, të cilat zyrtarisht do të vendosnin të drejtat e romëve.

Në Evropën qendrore dhe lindore, përveç aktiviteteve të lartpërmendura dhe atyre individuale, procesi i emancipimit të romëve u shty për diku njëzet vjet. Të nxitura nga ndryshimet politike pas vitit 1989, dhe të shtyrë nga nevojat urgjente të popullatës nën presion të madh ekonomik, u formuan

unionet regionale dhe trans-regionale në të gjitha vendet e Evropës lindore me minoritete domethënëse rome. Por fillimet e këtij procesi të ringjalljes sociale, politike, dhe kulturore dëshmuar të jenë të vështira, pasi që kishte tensione të mëdha në mesin e romëve për shkak të heterogjenitetit kulturor dhe social, dhe zbrazëtirave në mes të parimeve demokratike dhe autoriteteve tradicionale si dhe në mes të ambicieve politike dhe personale. Për më tepër, ekzistonte një kundërshtim i madh politik ndaj vetë-organizimit të romëve.

Në vitet e 1990-ta u bë shfaqja rapide e OJQ-ve të interesuara për monitorimin e të drejtave të njeriut, zhvillimin e banimit, konsultimit ligjor, promovimit arsimor, përmirësimit shëndetësor, ndihmës sociale, lobimit medial, trajnimit të ndërmjetësuesve, raportimit në shtyp, etj. E financuar nga fondacionet dhe trustet e huaja, kryesisht me seli në SHBA, dhe udhëhequr gati ekskluzivisht nga jo-romë, kjo “industri Cigane”, sikurse quhej me sarkazëm, dëshmoi dhe ende dëshmon të jetë problematike në disa aspekte. Përshtatshmëria dhe efikasiteti i përgjithshëm i



III. 6

Emil Ščuka (majtas), i zgjedhur si Sekretar Gjeneral i IRU në Kongresin e Katërt Botëror Romani dhe si President në kongresin e pestë, bisedon me Estref Abduramanoski, Presidenti i Unionit të romëve australian. Pragë, Korrik 2000. (nga Acton / Klímová 2001, f. 192)

III. 7

Lyobov Demetrova, Unioni i romëve rus, këndon himnin Romani për hapjen e Kongresit të Pestë Botëror Romani në Pragë. (nga Acton / Klímová 2001, f. 171)



III. 7

shumë përpjekjeve është vënë në dyshim vazhdimisht. Për shembull, angazhimi i organizatave ndërkombëtare me ndikim si “Instituti për Shoqëri të Hapur”, dhe themelimi i agjencive për avokim ligjor, më e njohura “Qendra Evropiane për të Drejtat Rome” (ERRC) në Budapest, ndihmuan në ngritjen e çështjeve të romëve të Evropës lindore në një nivel nacional dhe ndërkombëtar. Në anën tjetër, gati pa përjashtim nuk krijohej mundësi punësimi për romët, përkundër programeve të ndryshme trajnuese të projektuara për këtë qëllim.

PJESËMARRJA POLITIKE NË NIVEL NACIONAL DHE TË KOMUNITETIT

Rënia e regjimeve komuniste jo vetëm që iu mundësoi romëve të bëjnë aktivitete lobimi në vendet e tyre dhe jashtë vendit, por edhe iu dha mundësinë të merrnin pjesë në politikën nacionale. Ata iu ofruan partive politike dashamire për tu përfshirë në listën e nominimeve zgjedhore, ose krijojnë partitë e tyre, të cilat pastaj formojnë aleanca me partitë më të mëdha të orientimit të ngjashëm ideolo-

gjik. Në këtë mënyrë, kandidatët romë në Rumani, Bullgari, Republikën Çeke, Sllovakia dhe Hungari arritën të hyjnë në parlament. Në vitin 2004, politikani dhe antropologu hungarez, Livia Járóka (nga partia konservative FIDESZ-MPSZ), dhe eksperti i komunikimit dhe gazetari, Viktória Mohácsi (nga SZDSZ liberale), u bënë Anëtarë të Parlamentit Evropian. Anëtarë i parë i PE-së me origjinë rome ishte Juan de Dios Ramirez-Heredia, në vitin 1986 krijues dhe që nga atëherë President i Unionit Spanjoll të romëve, të cilët mbanin një ulëse në Parlamentin Evropian për një periudhë të shkurtë në vitin 1999.

Për shembull, në Çekosllovakia, në mars të vitit 1990 përfaqësuesit e inteligjencës rome regjistruan “Roma Obcanska Iniciativa” (Iniciativën Qytetare Rome, ROI) në Ministrinë e Punëve të Brendshme, një parti politike me baza gjithë nacionale. Udhëheqësi i saj, Emil Ščuka, më vonë u bë President i Unionit ndërkombëtar të romëve. Në qershor të vitit 1990, ROI u kandidua në zgjedhjet parlamentare në koalicion me Forumin Qytetar dhe Publikun Kundër Dhunës, lëvizje përkatëse politike që luajtën një rol vendimtar në rrëzimin e regjimit ko-

munist. ROI fitoi katër ulëse në Parlamentin Nacional Çek, dhe një mandat në Këshillin Nacional të Sllovakisë.

ROI vendosi të kandidohej si një parti e pavarur politike në zgjedhjet parlamentare të vitit 1992. Mirëpo, fitoi vetëm 0.53% të votave. Numri në rritje i konflikteve në mes të romëve dhe anëtarëve të popullsisë shumicë në mesin e viteve të 90-ta në mënyrë indirekte shpui në themelimin e një entiteti të ri politik të romëve i quajtur Inteligjenca Rome për Bashkëjetesë në Republikën Sllovake (RIS). Që nga viti 1998, politikanët romë tentuan të bashkonin partitë politike rome në Sllovakia, por pati vetëm negociata të pasuksesshme.

Zgjedhjet komunale të vitit 1998 ishin më të suksesshme. Romët kryesisht u paraqitën në listat e kandidatëve për ROI dhe RIS, dhe kandiduan si kandidatë të pavarur, por gjithashtu u paraqitën në listat e kandidatëve të partive tjera. 254 kandidatë romë kandiduan për pozitën e deputetit dhe shtatë kandidatë për pozitën e prefektit. Në fund, gjithsej 56 romë u zgjedhën si deputetë dhe gjashtë kandidatë romë u bënë prefekt. Tentimet për bashkim kanë vazhduar pa rezultate të mëdha. Ata dështuan të

HUNGARI: STRUKTURAT LOKALE DHE NACIONALE TË PËRKRAHJES

Si një kornizë institucionale nga shteti, Zyra e Minoriteteve Nacionale dhe Etnike (NEKH) u krijua në vitin 1990 për të zhvilluar dhe mbikëqyrur politikën minoritare në Hungari.

Dekreti i Minoriteteve i vitit 1993 zgjeroi të drejtat minoritare dhe vendosi sistemin unik të Hungarisë për Vetëqeverisjen Minoritare (VQM), që iu mundëson minoriteteve të formojnë organet e veta të zgjedhura për të punuar në partneritet me qeveritë lokale dhe nacionale. Sistemi VQM për romët dhe minoritetet tjera u krijua në vitin 1995. Përafërsisht 1,000 vetë-qeveri komunale rome pranojnë përkrahje shtetërore prej € 2,700 secila. Komunitetet janë të obliguara të sigurojnë infrastrukturën lokale për organizatat rome. Mirëpo, në këtë kontekst, komunitetet shpesh shpjegojnë se ata mund të veprojnë vetëm brenda “kufijve të tyre të mundësive”. Një problem tjetër madhor me sistemin VQM ka qenë fakti që deri kohëve të fundit çdonjëri mund të votojë për përfaqësues të këshillave minoritare; kështu, është vlerësuar se më pak se

dhjetë përqind të atyre që votuan për këshillat rome ishin vetë romët. Pas një ndryshim në ligj në qershor të vitit 2005, në mënyrë që të kishin të drejtën e votës, votuesit duhet të regjistrohen si romë nga organizatat rome. Por ekzistojnë përafërsisht një e treta e romëve që dëshirojnë të identifikohen haptazi si të tillë, dhe, siç argumentojnë shumë organizata, edhe më pak nga ta do të regjistrohen për zgjedhje.

Në vitin 2002 qeveria themeloi një Zyrë të re rome nën zyrën e Kryeministrit, për të koordinuar politikën rome në qeveri. Rrjedhimisht, temat specifike rome mund të diskutohen në nivelin më të lartë politik. Shumë nga përgjegjësitë e NEKH-s lidhur me integrimin social të romëve dhe koordinimi në politikën sektoriale i janë transferuar Zyrës së re rome. Përgjegjësia për kulturën rome dhe të drejtat minoritare mbesin me NEKH. Përveç kësaj, u themelua Përfaqësuesi Parlamentar për Minoritetet Etnike dhe Minoritare (Ombudspersoni i Minoriteteve). Ky institucion monitoron zbatimin e të drejtave minoritare, heton ankesat, dhe përcjell ndreqjen e shkëlqeve të të drejtave të minoriteteve nacionale dhe etnike.

III. 8

pajtoheshin në strategjinë e përbashkët për zgjedhjet nacionale në vitin 2002, të cilat, sikurse edhe zgjedhjet pas vitit 1990, nuk rezultuan në ulëse parlamentare për romët.

SFIDA E BASHKËPUNIMIT

Thënë në përgjithësi, marrë parasysh përqindjen e lartë të romëve në vendet e Evropës qendrore dhe lindore, ndikimi i tyre politik ende është shumë i vogël. Arsyeja për këtë situatë mund të shihet vetëm në injorancën dhe mungesën e përkrahjes financiare nga ana e joromëve, por gjithashtu në heterogjenitetin substancial të popullatës rome në tërë Evropën.

Shumë grupe dallojnë në mënyrë të konsiderueshme në aspektin e banimit, gjuhës (disa flasin Romani, të tjerët jo, ata që flasin, flasin variante të ndryshme dialektike të Romani, etj.), dhe nivelit të kufizimit, asimilimit dhe integritetit. Këta faktorë ndikojnë “romanipen” (“qenien rome”) – në përmbushjen dhe ruajtjen e kulturës specifike të romëve, prandaj edhe në vetë respektin dhe pozitën so-

cialë brenda shoqërisë rome. Anëtarët e grupeve “tradicionale”, “të vërteta” të romëve shpesh nuk do të bashkëpunonin me anëtarët e grupeve të “asimiluara”, të cilat në shumicën e rasteve konsiderohen inferiore.

Tensionet tjera brenda Lëvizjes Romani rezultojnë nga heterogjeniteti i personave të tyre udhëheqës. Ky grup përbëhet nga njerëz të cilët janë shumë të respektuar në mesin e romëve por shpesh, për shkak të mungesës së edukimit formal, nuk janë në gjendje të merren me strukturat moderne të administratës. Kohëve të fundit, ka qenë një numër në ngritje i njerëzve të rinj dhe të arsimuar të cilët po marrin përgjegjësitë politike. Dallimi në mes të lidhshirimit demokratik tradicional dhe modern ka shkaktuar një ngritje dramatike të organizatave rome dhe ka shkaktuar konkurrencë për të drejtën e përfaqësimit.

Përkundër dallimeve në mes të organizatave individuale, aleancat do të mund të krijoheshin në disa vende në mënyrë që të sigurohej së paku një formë pjesërisht e bashkuar e veprimit. Zgjidhja e konflikteve të brendshme ishte fundamentale, posaçërisht për shkak se organizatat individuale në vendet e

Evropës lindore dhe juglindore mezi dallonin nga njëra tjetra në kërkesat e tyre (njohja e romëve si minoritet etnik dhe nacional, përkrahja financiare e qendrave të pavarura kulturore, prania në media dhe përfaqësimi korrespondues në komitetet politike).

Në Evropën perëndimore, të ashtuquajturit romët “autochthonous” (autokton) dhe “allochthonous” (të posa arritur) janë duke u manipuluar politikisht kundër njëri tjetrit për shkak të statusit të ndryshëm ligjor. Për shembull, në Austri, romët të cilët kanë jetuar në vend për më tepër se një shekull njihen si minoritet, ndërsa në anën tjetër romët allochthonous, nuk njihen si të tillë, pa marrë parasysh nëse kanë nënshpëtim austriak apo jo. Prandaj ata mund të mos gëzojnë të drejtat dhe përkrahjen për grupet etnike. Rrjedhimisht, shumë organizata rome në Austri – sikurse në shumë vende tjera – fokusohen në çështjet ndër grupe, dhe bashkëpunimi në mes tyre është i kufizuar. Ekzistojnë disa përjashtime, për shembull Kongresi Nacional i Romëve me seli në Hamburg (RNC) ose “Romano Centro” në Vjenë, të cilët ofrojnë përkrahje ligjore, sociale dhe arsimore edhe për romët e posa arritur.

NUK KA NEVOJË PËR PATERNALIZËM

Themelimi i organizatës “Euro-Roma” në Bullgari shënon një ngjarje të famshme në zhvillimin e emancipimit romë. Në vitin 1998, 3,386 delegatë nga 205 organizatat komunale rome u mbledhën në Sofi me qëllim të konsolidimit të komunitetit romë, pavarësisht nga grupet që ata iu përkisnin. Të financuar ekskluzivisht nga romët – kryesisht Kalderaš –, “Euro-Roma” e bëri hapin e parë për të dëshmuar që romët nuk kanë nevojë për promovim nga shteti ose OJQ-të ndër-

kombëtare. Iniciativa shpiu në një sukses të konsiderueshëm të partive të ndryshme lokale rome në zgjedhjet komunale të vitit 1999. Edhe pse presioni i partive të themeluara vazhdoi të rritet – ku udhëheqësit romë u burgosën dhe u dërguan në ekzil – në vitet vijuese, zgjedhjet komunale të vitit 2003 sjelli një sukses edhe më të madh, ku 164 romë u zgjedhën si anëtarë të këshillave të ndryshme komunale. Përveç kësaj, një numër i konsiderueshëm i romëve u zgjedhën si prefektë të shumë fshatrave që kryesisht u banuan me romë.

III. 9

(shiko Marushiakova / Popov 2005, f. 433-455)

PERSPEKTIVAT E ARDHSHME

Duke iu falënderuar themelimit të organizatave rome, lobimit botëror, bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe institucionalizimit të çështjeve të tyre, sot romët janë në pozitë të ndikojnë në proceset politike në nivel komunal, nacional dhe ndërkombëtar.

Gjatë viteve të kaluara, departamente të ndryshme të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian janë duke trajtuar çështjet e romëve. Mirëpo, rekomandimet e tyre të shumta, ende nuk janë kthyer në vepra domethënëse. Në fund të fundit, janë dy zhvillime kohëve të fundit, të cilat, duke gjykuar nga projektimi i tyre dhe rezultatet e para, mund të dëshmojnë

si një hap i madh në procesin e emancipimit të romëve.

Në vitin 2004, “Forumi i Romëve Evropian dhe Udhëtarëve” (ERTF) u themelua në Strasbourg. Si një shoqatë pan-evropiane, forumi ka për qëllim bashkimin e organizatave ndërkombëtare dhe nacionale rome dhe lidhjen e tyre me Komisionin Evropian, Këshillin e Evropës, OSBE-në dhe organet dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Në mbledhjen e parë të ERTF-së në dhjetor të vitit 2005, Rudko Kańczynski, udhëheqës i Kongresit nacional të romëve, u zgjodh President. Forumi regjistroi organet e tij nacionale, të cilat janë përgjegjëse për regjistrimin e organizatave të ndryshme që marrin pjesë dhe kanë një votë në kuvendin e Forumit në Strasbourg. Në vitin 2005, pas një konference në Hun-

gari në vitin 2003, një iniciativë e nëntë qeverive të Evropës lindore (Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, „ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, Serbia, Rumania, Republika e Sllovakisë, dhe Mali i zi) së bashku me institucionet ndërkombëtare (përveç të tjerave Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, Banka Botërore), OJQ-të ndërkombëtare (si Instituti i Shoqërisë së Hapur) dhe organizatat ndërkombëtare rome shpallën vitet deri në vitin 2015 “Dekadën e Përfshirjes Rome”. Një vlerësim i rezultateve të kësaj iniciative do të jetë e mundshme vetëm në vitet vijuese, por vetë fakti që Dekada Rome përfshinë disa shtete të Evropës lindore në nivel qeveritar si dhe organizatat rome shënon një ngjarje të jashtëzakonshme në historinë e vetë-organizimit dhe emancipimit të romëve.

Bibliografia

Acton, Thomas / Klímová, Ilona (2001) The International Romani Union. An East European answer to West European questions? Shifts in the focus of World Romani Congresses 1971-2000. In: Guy, Will (ed.) Between past and future. The Roma of Central and Eastern Europe. Hatfield: University of Hertfordshire Press, pp. 157-226 | Hancock, Ian (2002) We are the Romani people. A me sam e Rromane džene. Hatfield: University of Hertfordshire Press | Marushiakova, Elena / Popov, Veselin (2005) The Roma - a Nation without a State? Historical Background and Contemporary Tendencies. In: Burszta, Wojciech et al. (eds.) Nationalism Across the Globe. Poznan: School of Humanities and Journalism, pp. 433-455 | Matras Yaron (1998) The development of the Romani civil rights movement in Germany 1945-1996. In: Tebbutt, Susan (ed.) Sinti and Roma in German-speaking society and literature. Oxford / Providence: Berghahn, pp. 49-63



© Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjete, elektronike (CD-Rom, Internet, etj.) ose mekanike, përfshirë fotokopjimi, incizimi apo sistemi i ruajtjes ose mbajtjes së informatave, pa lejen paraprake me shkrim nga Divizioni i Botimit, Drejtoria e Komunikimit (F-67075, Strasbourg cedex ose publishing@coe.int)



PROJEKT PËR EDUKIMIN E
FËMIJËVE ROMË NË EVROPË
<http://www.coe.int/education/roms>

[romani] PROJECT <http://romani.uni-graz.at/romani>